

**AKT - THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Alpha Concept" shpk**

Sot më datë 08.02.2022, ortakët themelues:

1. Z.Albjon Kureta, shtetas shqiptar, lindur në Berat, më datë 06.01.1991 dhe banues në Durrës, me numër personal identifikimi J10106061B, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
2. Z.Blerti Kroi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 30.04.1982 dhe banues në Tiranë, me numër personal identifikimi I20430057K person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

**VENDOSËN**

**Neni 1**

Të themelojnë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur:  
"Alpha Concept" shpk.

Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria "Alpha Concept" shpk zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

"Alpha Concept" shpk ka selinë e saj në Rruga "Donika Kastrioti" "Pall.14, Ap 12A, Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.

**Neni 4**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **për një afat deri më 20 vjet**. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë, ose të zgjasë afatin e saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.

### Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 200.000 (dyqindmijë) lekë, nga kontributet e ortakëve të ndara në 2 pjesë:

Ortakët marrin pjesë në kapitalin social si më poshtë:

1. z.Albjon Kureta 1 kuotë me vlerë 100.000 lekë, ose 50% e kapitalit
2. z.Blerti Kroj,1 kuotë me vlerë 100.000 lekë,ose 50% e kapitalit

### Neni 6

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë tërësisht të derdhura dhe të nënshkruara nga ortakët themelues në bazë të pjesëmarrjes së secilit në kapital. Kuotat e kapitalit nuk janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ose tek të tretët. Transferimi i kuotave, në çdo lloj forme,do të autorizohet me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, me shumicë të kualifikuar.Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

### Neni 7

Objekti i shoqërisë konsiston në aktivitetin:

Projektim dhe realizim i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumenteve, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut nëpërmjet internetit.

Aktivitet në fushën e pasurive të patundshme, nëpërmjet shitjes, blerjes, dhënies me qira të pasurive të ndryshme të paluajtshme, këshillimit juridik e financiar në këtë fushë.

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me qëllim fitimi me persona juridik e fizik të cfarëdolloj tipi dhe sido që të jenë krijuar ato.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu cdo lloj aktiviteti tjetër financiar, tregëtar, industrial, ndërtimi, import-eksporti etj., që do të shihen në interes të realizimit të objektit social të saj.

### Neni 8

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.

### Neni 9


Organet e shoqërisë“Alpha Concept” shpk janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Livio Kureta**, mbajtës i kartës së identitetit J50913072K, i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e



2  




administratorit, nga 11.02.2022 deri më 10.02.2025. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.

Administratori për probleme të vecanta, mund të delegojë persona të tjerë me prokurë të vecantë ose të përgjithshme.

#### Neni 10

Aktiviteti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të cdo viti. Me mbylljen e aktivitetit vjetor do të bëhet bilanci dhe llogaritë fitim/humbje. Fitimi i realizuar, pasi të zbriten rezervat ligjore, do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me vlerën e pjesëmarrjes së secilit në kapitalin social, në rast se ortakët nuk vendosin për krijimin e rezervave të tjera.

#### Neni 11

Shoqëria mund të priset në cdo kohë dhe për çfarëdo motivi sipas kritereve të përcaktuara në statut. Në rastin e prishjes së shoqërisë emërimi dhe revokimi i likuidatorëve i takon Asamblesë së Ortakëve e cila përcakton dhe kompetencat e tyre.

#### Neni 12

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akti të themelimit, si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.


Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt - Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.


### ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Alpha Concept” shpk

z. Albjon Kureta



Përfaqësues Ligjor z. Livio Kureta

LIVIO KURETA  


z. Blerti Kroj

